

**PROCESVERBAL**  
**nga seanca e 16-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuale,**  
**mbajtur më 29.5.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshilli të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Magdalena Davidovska Dovleva, Goran Radunoviq, Maja Damevska, dr.Ivana Stojanovska.

**Të pranishmit e tjerë: /**

Z. Petrushevski hapi seancën e 16-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 15-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 18.5.2023.
2. Propozim-vendim për miratimin e ribalancit të Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, me propozim – vendim.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të botuesit të medias së shkruar KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media.
4. Propozim-vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV-KANAL VIS SHPKNJ nga Strumica.
5. Propozim për fillimin e konsultimit publik për ndryshime dhe plotësime të „Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për maejen e lejes për transmetim në radio dhe televizion“.
6. Propozim-informacion drejtuar organit kompetent për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqëta për shkak të dyshimit se është kryer shkelje.
7. Të ndryshme.

**Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 15-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 18.5.2023, me tekstin e propozuar.

## **Pika 2**

Z.Trajçevski shpjegoi Propozimin për miratim të Vendimit për ribalancin e Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023. Ai shpjegoi se me ribalancin e propozuar nuk do të rriten të ardhurat dhe shpenzimet e Agjencisë, por vetëm mjetet do të rishpërndahen nga një furnizim publik i përealizuar në vlerë prej 5.310.000,00 denarë të cilat para së gjithash do të dedikohen për sigurimin e mëtejshëm të mjeteve për realizimin e furnizimit publik për mirëmbajtje të higjienës në hapësirat e punës të Agjencisë dhe për dy artikuj të tjerë që nuk janë shpenzuar, por për shkak të tendencave ekonomike në vend, pritet që në periudhën në vijim të ketë nevojë për plotësim me mjete financiare. Ai dhe njëherë theksoi se nuk do të ketë rritje të normës së të ardhurave si dhe as të shpenzimeve, por do të pasojë vetëm një rishpërndarje e brendshme e mjeteve (fondeve). Ai theksoi se në materialet janë të detajuara artikujt në të cilët do të bëhet ndryshimi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri solli Vendim me të cilin miraton Ribalancin e Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, me nr. 05-767/1 datë 16.2.2023.

Shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht do të jenë 149.530.505,00 denarë.

Ribalanci i propozuar do të sigurojë mjete financiare në vlerë totale (të përgjithëshme) prej 5.310.000,00 denarë, destinuar për:

- Rritjen e mjeteve financiare të nevojshme për lidhjen e kontratës për furnizim publik-mirëmbajtje të higjienës në hapësirat e punës të Agjencisë në shumë prej 436.600,00 denarë;
- Rritje e mjeteve financiare të nevojshme për pagesën e taksës gjyqësore në shumë prej 100.000,00 denarë;
- Rritjen e mjeteve financiare të nevojshme për pagesë të kompensimi mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë, në shumë prej 850.000,00 denarë dhe
- Rritjen e mjeteve financiare të nevojshme për pagesën e rrogës të të punësuarve në Agjencion, në shumë prej 3.923.400,00 denarë.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 3**

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dovleva shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të botuesit

të medias së shkruar KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për media. Ajo shpjegoi se ky botues i medias së shkruar nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin e ligjit, gjegjësisht mungojnë të dhëna që impresium duhet t'i përmbajë. Kur Agjencia ka kërkuar që të deklarohen në lidhje me shkeljen, ata kanë shpjeguar se kjo revistë botohet një herë në vit dhe se në botimin e ardhshëm do të përmbushin plotësisht detyrimin Ligjor.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme administrative, nr.03-1756/1 datë 6.4.2023 dhe njëzëri konkludoi ndaj Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime KOLOR MEDIA PLUS SHPK Shkup, botues i „The Economist”, t'i shqipton masë vërejtje publike, sepse në botimin me nr.5 të janarit 2023, nuk ka përmbushur plotësisht detyrimin nga neni 14 paragrafi (1) të Ligjit për media.

Në pajtim me Udhëzimin për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, detyrohet që në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat nga Ligji për media.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përpiloi Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj subjektit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht ose nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimi e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva shpjegoi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR TV-KANAL VIS SHPKNJP nga Strumica. Ajo shpjegoi se është kërkuar miratim që pronari aktual i vetëm të largohet dhe t'i bashkohet personi juridik Shoqëria për ndërtim, prodhim, tregti dhe shërbime SINERXHI GRUP INXHENERING SHPK Strumicë, pronarë të së cilës janë dy persona fizik. Spektori ka bërë kontroll në Regjistrin Qendror të RMV-së, ku është konstatuar se këta dy persona fizikë figurojnë si themelues të disa kompanive, por asnjëri prej tyre nuk është i regjistruar për veprimtari që janë në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye, është propozuar që të miratohet ndryshimi i planifikuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim, ku lejohet ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, me tekstin e propozuar në vendim.

Ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë nuk paraqesin koncentrim të paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, respektivisht ky ndryshim nuk bie në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm duhet ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

## Pika 5

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për fillimin e konsultimit publik për ndryshim dhe plotësimin e „Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion“. Ai shpjegoi se transmetuesi KANAL 77 më 24 mars të vitit të kaluar ka paraqitur iniciativë të njëjtë, por në të njëjtën kohë e ka dorëzuar iniciativën edhe në Gjykatën Kushtetuese dhe më pas Këshilli ka konkluduar se deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese të gjitha aktivitetet e bazuara në këtë iniciativë do të pezullohen. Në ndërkohë, gjykata ka inicuar procedurë për vlerësimin e kushtetushmërisë së kësaj Rregulloreje. Më 17 maj të këtij viti transmetuesi KANAL 77 sërish ka paraqitur iniciativë për ndryshimin e Rregullores në pjesën e kushteve kuadroviqe. Kërkesa është që të ndërpritet mundësia për angazhimin dhe punësimin e personave tek transmetuesit me kontratë pune ose kontratë autoriale, por të punësohen nëpërmjet Agjencisë për punësim. Ai përkujtoi se paraprakisht ka pasur situatë të tillë me Kërkesë të SHGM-së për ndryshim të Rregullores, që transmetuesit të marrin shkresë. Duke qenë se procedura në Gjykatën Kushtetuese është në vazhdim e sipër, sugjerohet që të hapet një konsultim publik, të ftohen transmetuesit dhe propozuesi për tu shprehur dhe të shihen qëndrimet e tyre dhe ndoshta ndërkohë Gjykata Kushtetuese do të sjellë një vendim përfundimtar.

Z. Ajdini tha se për aq sa i njeh mundësitë dhe gjendjen ekonomike të transmetuesve, edhe me Rregulloren ekzistuese për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion, vështirë se i plotësojnë këto kritere. Kur kjo Rregullore u vendos si Draft verzion për diskutim publik në vitin 2014 nga transmetuesit nuk ishte dorëzuar asnjë vërejtje. Tani ai supozon se qëllimi i parashtruesit të iniciativës është i qartë, por siç ka theksuar dhe drejtori, ai pajtohet që të ketë konsultim publik për të parë si do të jetë rezultati përfundimtar.

Z. Fidanoski tha se përkrah hapjen e konsultimit publik për këtë çështje. Ai tha se pajtohet me deklaratën e paraqitur në material për këtë pikë, se Agjencia dhe anëtarët e Këshillit deri në fund do të respektojnë plotësisht çdo vendim që do merret si përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese për këtë çështje. Sipas tij, për të marrë vendimin përfundimtar duhet të kalojë një periudhë e caktuar, e cila sipas vlerësimit të tij, duke ditur dinamikën e punës së Gjykatës Kushtetuese, mund të ndodhë pas përfundimit të pushimeve verore. Deri atëherë, ai tha, nuk është keq që personi (esnafi) të pyetet për drejtimin e mendimit bazuar në ndryshimin e kësaj Rregulloreje, për çështjen që e preokupon opinionin publik për një kohë të gjatë, para së gjithash dhe mediat. Sipas tij, Agjencia në mënyrë profesionale dhe solide i ka dërguar përgjigje Kërkesës nga Gjykata Kushtetuese lidhur me iniciativën, sepse janë të shënuara të gjitha aspektet që Agjencia duhet t'i japë si argument pse është në fuqi një Rregullore e tillë. Ai beson se do gjendet zgjidhja e duhur, se konsultimi publik që do të vijon fillimisht do të zgjojë interes solid nga mediat dhe prej tyre presim një kontribut konstruktiv për të marrë më të mirën e mundshme për Rregulloren e ardhshme që to të miratohet përfundimisht si ndryshim nga ai ekzistues dhe pas vendimit përfundimtar të miratuar nga Gjykata Kushtetuese.

Z. Petrushevski tha se edhe për të është propozim i mirë, mbajtja e një konsultimi publik, ku do të ketë mundësi të shihet në përqindje se sa nga transmetuesit janë për këtë iniciativë dhe sa janë për anëtarin ekzistues. Duke ditur mundësitë financiare, ai supozon se të gjitha radiot dhe televizionet e vogla do të jenë kundër këtij vendimi, por mbetet të shihet mendimi i tyre përfundimtar.

Z.Fidasoski tha se ende nuk dihet se si do të jetë, me konsultim publik mund të merren propozime të tjera për ndryshimin e numrit të të punësuarve obligativ dhe të ngjashme që do të jenë të pranueshme për të gjithë.

Z. Petrushevski tha se prandaj është mirë të dëgjoen më shumë mendime.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Konkluzionin për fillimin e konsultimit publik për ndryshimin e „Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrove për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion“ (Tekst i pastruar) nr.01-3747/1 datë 6.10.2022, pas vendimit të marrë nga Gjykata Kushtetuese e RMV-së, në këtë proces do të ftohen të gjitha palët e interesuara (radiot dhe televizionet) të shprehin mendimet e tyre lidhur me ndryshimet e mundshme të Rregullores në fjalë.

### **Pika 6**

Z.Trajçevski shpjegoi Propozim-informacionin drejtuar organit kompetent për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta për shkak të dyshimit se është kryer shkelje Ai sqaroi se Agjencia është njoftuar se TV Telma ka nënshkruar kontratë për të drejtën e autorit për një serial të caktuar televiziv që operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik Telekom i Maqedonis (Makedonski Telekom) e transmeton në njërin nga kanalet përmes rrjetit të tij. Por meqënëse TV Telma deklaroi se ka të drejtën e autorit, u sugjerua që të dërgohet informacion tek organi kompetent dhe nëse ka shkelje të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, të inicohet procedura përkatëse.

Këshilli i Agjencisë, në bazë të Kërkesës së pranuar për konstatimin e transmetimit të paautorizuar dhe të paligjshëm nga SHTR TELEVISION MAKPETROL SHPKNJP TELMA Shkup (Nr.ynë.ark.11-2191/1 datë 22.5.2023) me të cilën TV TELMA kërkon që Agjencia të ndërmarrë veprimet e duhura në pajtim me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 7 nga LSHMAAV, njëzëri vendosi që Ministrisë së Punëve të Brendshme – Qendra për Luftën e Krimin të Organizuar dhe të Rëndë t'i dorëzon informacion për ekzistimin e dyshimit për shkelje të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta nga operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik Makedonski Telekom Shoqëri Aksionare për komunikim elektronik-Shkup, me tekstin e propozuar.

### **Pika 8**

#### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-2231/7**

**05.06.2023**  
**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**  
**Audio dhe Audiovizuale**  
**Kryetari i Këshillit,**  
**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

